

**AKT  
THEMELIMI I  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“Italian Security Consulting” Shpk**

Ortaku themelues:

**Pierluigi Pascuzzi** nenshtetas italian, i biri i **Pascuzzi Gaetano**, i datelindjes 31/05/1963, lindur ne Roma (RM), Itali dhe banues ne, Via Antonio Santoro, Nr34, Roma (RM), Itali, person madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. YC1547933.

me deshiren dhe vullnetin e tij te lire, ne perputhje me Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te krijojte nje shoqeri tregtare mbeshtetur ne dispozitat e meposhtme:

Neni 1

Shoqeria tregtare qe krijohet emerohet **“Italian Security Consulting” Shpk**. Emertimi tregtar vendoset ne te gjitha aktet dhe dokumentat e shoqerise ne marredheniet me persona te trete, si dhe ne vulen zyrtare te saj.

Neni 2

Selia qendrore e shoqerise eshte ne Tirane ne adresen ne Rruga : “Mine Peza”, Hyrja 1, Apartamenti N/3, Zona Kadastrale 8350, Pasuria Nr.4/6-N/3. Selia qendrore e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise apo edhe jashte saj, nepermjet degeve, filialeve, agjencive apo zyrave te perfaqesimit, kompetencat e te cilave percaktohen nga Asambleja e Ortakeve.

Neni 3

Shoqeria **“Italian Security Consulting” Shpk** krijohet ne formen e “shoqerise me pergjegjesi te kufizuar” ne te cilen ortaku mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara sipas dispozitave qe parashikon ligji.

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte me afat te pakufizuar. Ky afat mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Shoqeria fiton personalitetin juridik dhe mund te filloje veprimtarine e saj mbas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.



#### Neni 5

Objekti i veprimtarise se Shoqerise tregtare **“Italian Security Consulting” Shpk.** eshte:

Konsulence per ruajtjen e sigurimit te objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizik e juridik, sigurimin e mbrojtjen e jetes dhe shendetit te personave fizik ose juridik, shtetas shqiptar ose te huaj, BarRestorant, hoteleri, etj. Import-eksport dhe instalim të sistemeve të alarmit, të pajisjeve të vëzhgimit dhe kontroll me sallë operative, prodhim dhe përdorim të tyre, si dhe organizimi i grupeve të gatshme të mbrojtjes dhe ndërhyrjes. Prodhim, mirëmbajtje, tregtim i pajisjeve dhe lëndëve të shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit. Organizimi i grupeve të mbrojtjes dhe shpëtimit kundra zjarrit dhe emergjencave natyrore. Aktiviteti kembimi valutor (Exchange). Tranferta parash dhe vlerash monetare brenda dhe jashte vendit. Agjensi udhetimesh Turistike, brenda dhe jashte vendit. Aktiviteti i dhenies se makinave me qera. Aktiviteti i Sherbimit Taksi.

#### Neni 6

Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte ne vleren 110.000 (Njeqind e dhjete mije) leke. Kapitali i shoqerise eshte ndare ne 1 (nje) kuote (pjese), me vlere 110.000 (Njeqind e dhjete mije) leke. Nje kuote ka gjithashtu vleren e nje vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve.

Ne momentin e krijimit, kapitali i regjistruar i shoqerise eshte shlyer teresisht nga ortaku themelues i shoqerise dhe kuotat do te zoterohen nga ortaku i vetem :

- a) **Pierluigi Pascuzzi**, zoterues i 100 % te kapitalit themeltar te Shoqerise ose 1 kuotë (pjese) me vlere te pergjithshme 110.000 (Njeqind e dhjete mije) leke te shoqerise **“Italian Security Consulting” Shpk.**

#### Neni 7

Organi me i larte drejtues dhe vendimmarres i shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, e thirrur dhe mbledhur ne menyre te ligjshme, e cila perfaqeson teresisht teresine e ortakeve te shoqerise.

Kompetencat e Asamblese se Ortakeve percaktohen nga ligji dhe Statuti i Shqoqerise. Asambleja i ushtron kompetencat nepermjet vendimeve, qe merren prej saj sipas kuorumit te krekuar prej ceshtjes te caktuar, kourum, i cili percaktohet nga ligji dhe Statuti.

#### Neni 8

Shoqeria administrohet nga nje ose me shume administratore, me mandat 5 vjecar me te drejte riemerimi, te cilet edhe mund te mos jene ortake ne shoqeri. Nese Asambleja e

pergjithshme emerion me shume se nje administrator, ata e administrojne shoqerine ne menyre autonome.

Kompetencat e Administratoreve percaktohen nga ligji, Statuti ose aktet e tjera te brendshme te shoqerise.

Emerimi dhe shkarkimi i administratoreve behet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve me shumice te zakonshme.

#### Neni 9

Shoqeria per ushtrimin e aktivitetit te saj krijon dhe disponon fondet e nevojshme, perfshire fondin rezerve dhe fonde te tjera per zhvillim. Perberja, madhesia, burimet e krijimit dhe perdorimi i cdo fondi ne perputhje me rrethanat, interesat dhe objektin e veprimtarise se shoqerise, vendosen nga Asambleja e Ortakeve duke respektuar legjislacionin ne fuqi.

#### Neni 10

Veprimtaria ekonomike e shoqerise ndahet ne periudha financiare 12 mujore. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 dhjetor te cdo viti kalendarik, me perjashtim te vitit te pare, i cili fillon nga data e krijimit te shoqerise dhe mbaron me 31 dhjetor.

Ne mbyllje te vitit financiar, ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi, shoqeria harton dhe paraqet ne organet tatimore, bilancet financiare.

Administratori hartojn raportin mbi administrimin, gjendjen financiare, llogarite vjetore dhe inventaret e shoqerise, te cilat ja paraqesin per miratim Asamblese se Ortakeve brenda 6 mujorit te pare te viti pasardhes.

#### Neni 11

Veprimtaria e Shoqerise mbaron me vendim te Asamblese se Ortakeve ne rast se nuk eshte e mundur te realizohet objekti i veprimtarise se Shoqerise, ne rast se kjo veprimtari rezulton me humbje te vazhdueshme ose ne raste te tjera qe parashikon ligji.

Kur vendoset mbyllja e aktivitetit te shoqerise, ne cfaredo kohe dhe per cfaredo arsye, emerohet nje ose me shume likujdatore per te ndjekur dhe perfunduar procedurat e likujdimit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ne perfundim te procedurave te likujdimit, pasuria e Shoqerise qe mbetet pas shlyerjes se te gjitha detyrimeve ndaj te treteve, do te shperndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me pjesen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

#### Neni 12


Si rregull, cdo mosmarreveshje ortaket do ta zgjidhin me mirekuptim midis tyre. Ne rast te kundert, kompetente oer zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane.

Neni 13

Veprimtaria e shoqerise ne teresi do te rregullohet nepermjet Statutit dhe Akteve te tjera te brendshme te shoqerise si dhe Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe legjislacionin shqiptar ne teresi.

**ORTAKU I VETEM  
I SHOQERISE TREGETARE  
"Italian Security Consulting" Shpk**

Pierluigi Pascuzzi



Tirane me: 07/07 /2023